



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 570 Akti

Nr. 638 Vendimi
Tiranë, më 29.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 28.3.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Englantina Shehu**, aktualisht ushtron detyrën e prokurores, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Etleda Çiftja kryesuese dhe Alma Faskaj anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionerja Etleda Çiftja. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

¹ Shkresë nr.*** prot., datë 29.3.2018.

- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Englantina Shehu*.
7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 20.3.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Englantina Shehu dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Englantina Shehu i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.
11. Znj. Englantina Shehu, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 27.3.2023. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

² Raport nr. *** prot., datë 31.10.2017 i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³ Raport nr. *** prot., datë 9.5.2022, i miratuar me vendimin nr. **, datë 9.5.2022, të KLP-së.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 27.3.2023.
13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 28.3.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Englantina Shehu ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
 - d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
 - f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
 - g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Englantina Shehu, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
24. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Englantina Shehu në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, e dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017 në zbatim të ligjit, e cila ka deklaruar:
25. **Apartament⁴ me sip. 62.30 m², blerë në vitin 2015, në Tiranë**

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet vijuese: (1) kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë 2.2.2015, me palë shitëse N. D dhe palë blerëse Englantina Shehu dhe E.L për blerje apartamenti me sip. 62.3 m², rruga "D.B", Tiranë, kundrejt vlerës 52.000 euro. Blerësit kanë transferuar në llogarinë bankare të shitësit këstin e parë prej 22.000 euro në datën 2.12.2014 në "Tirana Bank". Diferenca prej 30.000 euro do të shlyhet me kredi nga "Tirana Bank"; (2) dokumentacioni i njehsuar me origjinalin sipas vërtetimit nga noteri nr. *** rep., datë 28.12.2016: certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 26.8.2015 për pasurinë apartament me sip. 62.3 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve Englantina Shehu dhe E.L, shoqëruar me kartelë pasurie me të dhëna të njëjta dhe hartë treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 21.1.2015 për pasurinë apartament me sip. 62.3 m², me nr. ***, në pronësi të N.D + kartelë pasurie me të dhëna të njëjta; vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 4.8.2011, e lëshuar në datën 13.4.2012 për pasurinë nr. *** në pronësi të N.D, si dhe hartë treguese e pasurisë; kontratë kredie bankare dhe hipotekore nr. ***, datë 13.3.2015 me palë kredidhënëse "Tirana Bank" dhe palë kredimarrëse Englantina Shehu dhe E.L për marrje kredie në shumën 4.200.000 lekë, me afat 15 vjet. Kredia do të sigurohet nga hipoteka mbi pasurinë apartament me sip. 62.3 m², rruga "D.B", Tiranë, në pronësi të N.D; nxjerrje llogarie nga "Tirana Bank" për E.L, ku në datën 2.12.2014 transferohet shuma 20.000 euro nga shtetasia N.L; depozitohet shuma 2.000 euro nga E.L dhe transferohet për N.

Vlera e deklaruar: 52.000 euro
Burimi i krijimit: i. kredi nga “Tirana Bank” në shumën 4.200.000 lekë (30.000 euro);
ii. ndihmesë e prindërve të bashkëshortit (kursime nga pagat, shpërblim gjyqi) në shumën 20.000 euro;
iii. shuma 2.000 euro kursime të bashkëshortit përgjatë viteve 2008 – 2014.
Në DPV-në e vitit 2015: subjekti ka deklaruar të njëjtin burim për blerjen e apartamentit.
Mënyra e fitimit: kontratë shitjeje me kusht e datës 2.2.2015
Pjesa takuese: 50%

Hetimi i Komisionit

26. Për këtë pasuri Komisioni ka hetuar dhe kërkuar informacion si vijon:

26.1 Nga sistemi multifunksional i ASHK-së⁵ ka rezultuar se në emër të shtetasve Englantina Shehu dhe E.L figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 62.3 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, e ndodhur në Tiranë.

26.2 ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁶ ka dërguar dokumentacionin tekniko-ligjor të pasurisë apartament me nr. ***, ku dokumentohet blerja e kësaj pasurie nga shtetasit Englantina Shehu dhe E.L përmes kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 2.2.2015.

26.3 FSHU-ja⁷ ka informuar se shtetasja Englantina Shehu nuk rezulton të jetë abonente dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike, ndërsa me gjeneralitetet E.L identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit në instancën Tiranë. Sipas të dhënave në sistemin e faturimit, identifikohet kontrata e lidhur në adresën rruga “D.B”, në datën 22.4.2015, e cila përkon me adresën e pasurisë së deklaruar nga subjekti.

26.4 UKT-ja⁸ ka informuar se në emër të shtetasve Englantina Shehu dhe E.L nuk rezulton asnjë e dhënë për kontratë për shërbime me Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., të regjistruara në sistemin e tyre.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

D shuma prej 22.000 euro; vendim nr. **, datë 18.6.2008, e Gjykatës së Apelit Tiranë me palë paditëse Ministria e Punëve Publike, palë e paditur N.L, me objekt “kundërshtim i vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil”, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë dhe lënia në fuqi e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil, dokument i njehsuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 23.12.2016; shkresë nga shoqëria përmbarimore ** nr. *** prot., datë 4.11.2015, me të cilën i drejtohet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e vendimit gjyqësor. Sipas shkresës, pagesa në zbatim të vendimit është bërë e pjesshme, në total është paguar deri në datën 19.8.2015 shuma 6.723.895 lekë; çek nga “Raiffeisen Bank” datë 4.4.2012, ku urdhërohet nga *** pagesa e shumës prej 100.800 lekësh për N.L; çek nga “Raiffeisen Bank” datë 27.12.2013, ku urdhërohet nga *** pagesa e shumës prej 320.000 lekësh për N.L; çek nga “Raiffeisen Bank” datë 29.12.2011, ku urdhërohet nga ** pagesa e shumës prej 1.053.609 lekësh për N.L; kërkesë për transfertë fondesh nga “Raiffeisen Bank” datë 30.6.2014 me përfitues N.L dhe urdhërues *** sh.p.k., shuma 3.940.000 lekë.

⁵ Vërtetimet e lëshuara elektronikisht në datën 24.1.2023 për aplikimet nr. **, datë 18.1.2023 dhe aplikimet nr. **, datë 18.1.2023.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2023.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 2.4.2021.

⁸ Shkresë nr. K-*** prot., datë 30.3.2021.

27. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti Englantina Shehu dhe shtetasi E.L⁹ kanë nënshkruar në cilësinë e blerësve një kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë 2.2.2015, me shitësin N.D, për blerjen e një apartamenti me sip. 62.3 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 7.2 m², të ndodhur në katin e katërt teknik, shk. *, në godinën * dhe * kate, në rrugën “D.B”, Tiranë, kundrejt çmimit 52.000 euro, ku shuma prej 22.000 euro është transferuar në llogarinë e shitësit në datën 2.12.2014, ndërsa diferenca prej 30.000 euro do të shlyhej me kredi nga “Tirana Bank”.

27.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja me kusht e kësaj pasurie, duke qenë se një pjesë e vlerës së apartamentit do të paguhej me kredi bankare. Si kusht për realizimin e kontratës palët kanë përcaktuar se blerësit nuk do të regjistrojnë pronën në emrin e tyre, pa shlyer vlerën e plotë të apartamentit, e cila do të kryhej përmes kredisë bankare. Sipas kontratës, regjistrimi i pronës në emër të blerësve do të kryhej pas lëshimit të një deklarate noteriale nga pala shitëse, e cila deklaronte shlyerjen e plotë të vlerës së apartamentit dhe shpreh dakordësinë për kalimin e pronësisë nga shitësi te blerësi. Kjo deklaratë noteriale do të lëshohej nga pala shitëse në momentin e disbursimit të shumës së kredisë prej 30.000 euro.

27.2 Nga aktet në dosje rezulton se shitësi N.D ka lëshuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.6.2015, ku deklaronte se kushti i vendosur në kontratën e shitjes datë 2.2.2015 është plotësuar, pasi kredia është marrë pranë “Tirana Bank” sh. a., nga pala blerëse dhe ka kaluar në llogarinë e noteres sipas fotokopjes së transfertës. Për rrjedhojë, shitësi ka rënë dakord që të kryhet kalimi i pronësisë tek blerësit E.L dhe Englantina L.

27.3 Subjekti Englantina Shehu dhe E.L kanë regjistruar apartamentin në emrin e tyre duke u pajisur me certifikatë pronësie në datën 26.8.2015, ku secili figuron bashkëpronar me ½ pjesë të apartamentit.

27.4 Në DPV-në vitit 2015 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi lagjja “D. B”, kompleksi ***(prapa restorant “Gj”, Tiranë, adresa rruga “K.D”, nr. *, Korçë, e cila përkon me vendndodhjen e apartamentit të blerë nga subjekti.

Lidhur me mënyrën e pagesës së apartamentit

28. Në kontratën e shitjes datë 2.2.2015, palët kanë përcaktuar se shuma 22.000 euro është transferuar në llogarinë bankare të shitësit N.D në datën 2.12.2014, ndërsa diferenca e çmimit prej 30.000 euro do të shlyhej me kredi bankare.

28.1 Nga të dhënat e llogarisë bankare të shtetasit E.L në “Tirana Bank”¹⁰ ka rezultuar se në datën 2.12.2014 ky shtetas ka transferuar shumën 22.000 euro në llogarinë e shitësit N.D, me përshkrimin “kësti I, kontratë nr. ***, datë 1.12.2014”.

28.2 Sipas llogarisë bankare të shtetasit E.L rezulton se shuma prej 20.000 euro i është transferuar nga babai i tij N.L në datën 2.12.2014, ndërsa shuma 2.000 euro është depozituar *cash* nga E.L.

⁹ Sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard, në periudhën e blerjes së apartamentit subjekti ka qenë e fejuar me shtetasin E. L, me të cilin ka lidhur martesë ligjore në datën 17.7.2016.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

28.3 Komisioni i ka kërkuar¹¹ subjektit të depozitohet këtë kontratë të datës 1.12.2014 të lidhur me shitësin N.D, të cilën subjekti e ka depozituar dhe ka shpjeguar¹² se ajo dhe bashkëshorti i saj fillimisht kanë lidhur me shtetasin N.D një kontratë sipërmarrjeje me nr. ***, datë 1.12.2014, për blerjen e këtij apartamenti. Subjekti ka shpjeguar se edhe pse kontrata mbante këtë titull “kontratë sipërmarrjeje”, ajo në thelb ishte një kontratë shitblerjeje me kusht, pasi apartamenti ishte i ndërtuar dhe i regjistruar në regjistrin hipotekor.

28.4 Sipas shpjegimeve të subjektit, në atë kohë ka insistuar në lidhje me titullin dhe disa pika të kontratës, por noterja ka këmbëngulur se kështu e kishin praktikën, pasi në këtë formë vepronin dhe banka me këtë kontratë jepte edhe kredinë. Gjendur në këto kushte është nënshkruar kjo kontratë sipërmarrjeje në bazë të së cilës është kaluar edhe shuma prej 22.000 euro nga bashkëshorti E.L në llogarinë e shtetasit N.D.

28.5 Më tej, subjekti ka shpjeguar se pas pagimit të kështit të parë kanë aplikuar pranë “Tirana Bank” në datën 4.12.2014 për marrjen e një kredie me qëllim pagesën e kështit tjetër të kontratës në shumën 30.000 euro, ku si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar për përfitimin e kredisë ka qenë edhe kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 1.12.2014. Subjekti ka saktësuar se: *“Pas rreth një jave jam kontaktuar nga drejtoresha e degës së ‘Tirana Bank’, e cila më ka bërë me dije se kontrata e dorëzuar nuk plotësonte kushtet që të financonin kredinë. Ndër të tjera ishte konstatuar se në kushtet kur shtetasi N.D ishte i martuar mungonte edhe pëlqimi i bashkëshortes për tjetërsimin e pasurisë, apartamentin që ne do të blinim. Ndodhur në këto kushte, kam kontaktuar me noteren dhe më ka siguruar që nuk ishte problem dhe se kontrata do të anulohet. Në datën 2.2.2015 kemi lidhur kontratën me nr. ***, me titull ‘kontratë shitjeje me kusht’. Në kushtet kur kësti i parë i kontratës ishte paguar, ne specifikuam dhe shënuam në kontratë të gjitha detajet e kësaj transferte, numrin e transaksionit dhe faktin që ishte paguar që në datën 2.12.2014”*.

28.6 Subjekti ka depozituar mandatin bankar të “Tirana Bank” për transfertën e shumës 22.000 euro, të kryer në datën 2.12.2014 në llogarinë e shitësit. Subjekti thekson faktin se të dyja kontratat, në të gjitha detajet e tyre, kanë të njëjtat palë, të njëjtin objekt, të njëjtin çmim dhe mënyrë të pagimit të tij.

28.7 Lidhur me diferencën së çmimit prej 30.000 euro, nga dokumentacioni bankar ka rezultuar se subjekti Englantina Shehu dhe shtetasi E.L kanë lidhur me “Tirana Bank” kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 13.3.2015, për marrjen e një kredie në shumën 4.200.000 lekë, e cila do të trajtohet në pikën 29 në vijim, rubrika e burimeve të krijimit të pasurisë.

28.8 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit të rivlerësimit, me shitësit e apartamentit, N.D dhe A.D, dhe nga përgjigjja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier¹³, ku subjekti ka ushtruar funksionin e prokurores, nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të këtyre shtetasve.

¹¹ Përmes pyetësorit me email datë 15.2.2023.

¹² Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 22.2.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 15.2.2023.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 6.3.2023.

28.9 Komisioni ka verifikuar vlerën e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, referuar çmimit të EKB-së¹⁴ në vitin 2015, ku në zonën ** ku ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti vlera e tregut të lirë është 75.000 lekë/m² dhe për apartamentin me sip. 62.3 m² çmimi i apartamentit do të ishte 4.672.500 lekë (rreth 33.945 euro), ndërsa subjekti e ka blerë 52.000 euro.

28.10 Referuar dokumentacionit të pronës¹⁵ kjo pasuri është rivlerësuar në vlerën 7.840.000 lekë (rreth 56.900 euro) sipas mandatarkëtimit datë 28.3.2012.

- Nga hetimi i kryer nuk ngrihen dyshime për çmimin e blerjes së apartamentit, i cili është më lart krahasuar me koston mesatare të EKB-së në vitin 2015.

Burimi i krijimit

29. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit:

- i) kredi nga “Tirana Bank” në shumën 4.200.000 lekë (30.000 euro);
- ii) ndihmesë nga prindërit e bashkëshortit (kursim nga pagat, shpërblim gjyqi) në shumën 20.000 euro;
- iii) kursime të bashkëshortit në punën e tij gjatë viteve 2008 – 2014, në shumën 2.000 euro.

29.1 Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme të deklaruara nga subjekti për blerjen e apartamentit, si vijon:

i. Kredi nga “Tirana Bank” në shumën 4.200.000 lekë (30.000 euro)

29.1.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare dhe hipotekore nr. ***, me nr. ***, datë 13.3.2015, të nënshkruar midis kredithënësit “Tirana Bank” dhe kredimarrësve Englantina Shehu e E.L, për marrjen e një kredie bankare në shumën 4.200.000 lekë, me qëllim blerjeje shtëpie, me afat 15 vjet, duke filluar nga data e disbursimit.

29.1.2 Në kontratë përcaktohet se pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 22.000 euro.

29.1.3 Si garanci për ripagimin e kredisë kredimarrësit kanë ofruar vendosjen e barrës hipotekore në favor të bankës mbi apartamentin me sip. 62.3 m², i cili do të blihej prej tyre, në pronësi të shtetasit N.D, ku ky i fundit ka nënshkruar edhe kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 13.3.2015.

29.1.4 Nga të dhënat e llogarisë bankare të subjektit pranë “Tirana Bank”¹⁶ evidentohet disbursimi i kredisë prej 4.200.000 lekësh në datën 14.4.2015 dhe transferimi i kësaj shume në datën 27.5.2015 në llogarinë e noterit¹⁷ M.D, e cila ka përpiluar aktin e shitblerjes me përshkrimin “transfertë për M.D, kalim sipas kontratës nr. ***”.

¹⁴ Udhëzimi nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2015” (botuar në Fletoren Zyrtare 175/2015, datë 6.10.2015).

¹⁵ Referuar vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 4.8.2011, të lëshuar në datën 13.4.2012, në emër të shitësit N.D, si dhe pasqyrës llogaritëse të tatimit për kalimin e pronësisë.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

¹⁷ Në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të përbashkët nr. ***, datë 30.1.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”.

29.1.5 Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit¹⁸ nga viti 2015 dhe në vijim, te rubrika e “detyrimeve financiare” subjekti ka deklaruar shumën e kredisë, si dhe detyrimin e mbetur të pashlyer çdo vit.

- Referuar historikut të lëvizjeve të llogarisë së subjektit pranë “Tirana Bank” provohet disbursimi i kredisë me shumë 4.200.000 lekë në llogarinë e subjektit dhe kalimi i kësaj shume në llogarinë e noteres në datën 27.5.2015 për pagesën e këstit të apartamentit.

ii. Të ardhurat (ndihmë) nga prindërit e bashkëshortit në shumën 20.000 euro

29.1.6 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e apartamentit ka shërbyer edhe shuma prej 20.000 euro e dhënë në formë ndihme nga prindërit e bashkëshortit, me burim kursimet e tyre nga pagat dhe shpërblimet e gjyqit.

29.1.7 Komisioni, për shkak të dhurimit të shumës 20.000 euro, ka konsideruar shtetasin N.L si “person tjetër të lidhur”, në kuptim të neneve 3/14 dhe t 32/4 të ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar informacion pranë institucioneve vijuese si:

29.1.8 ISSH-ja¹⁹ ka dërguar të dhëna lidhur me të ardhurat e realizuara nga shtetasit N dhe L.L (vjehtërit e subjektit), ku evidentohet se shtetasi N.L përfiton pension pleqërie dhe pension suplementar shtetëror nga muaji nëntor 2017 dhe në vijim, ndërsa shtetasja L.L ka realizuar të ardhura nga punësimi në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë nga muaji janar 2012 deri në dhjetor 2019 (periudhë e daljes në pension).

29.1.9 Gjithashtu, nga informacioni i dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë²⁰ ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit, N.L dhe L.L, nuk rezultojnë të kenë pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emrin e tyre. Referuar ekstraktit historik të punonjësit të dërguar nga DPT-ja evidentohen të ardhurat e realizuara nga shtetasja L.L nga janari i vitit 2012 pranë punëdhënësit Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.

29.1.10 Referuar deklarimeve²¹ të subjektit, arsyeja e kësaj dhurate ishte në formë ndihme për të paguar vlerën 30% që nevojitej për të blerë një apartament banimi të financuar me kredi nga banka, si dhe në formë dhurate për martesë. Subjekti ka deklaruar se vjehtëri i saj N.L nuk ka pranuar të shpenzonte për të bërë dasmën tradicionale dhe burimi i kësaj dhurate ishin kursimet familjare dhe shpërblimet nga një vendim gjyqësor në favor të vjehtërit N.L.

29.1.11 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.9.2021, të lëshuar nga shtetasi N.L, i cili, ndër të tjera, deklaroi se në datën 2.12.2014 i ka dhënë djalit të tij E.L në formë ndihme (dhuratë) shumën 20.000 euro (duke qenë se djalit nuk i bëri dasmë dhe shpenzimet që do të harxhonte për dasmë ia dhuroi në formë ndihme për blerjen e shtëpisë), ku burim i kësaj shume

¹⁸ Te rubrika “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2021.

²¹ Në pyetësorin standard.

ishin kursimet e tij familjare ndër vite dhe shpërblimet/pagesat që ka marrë në zbatim të një vendimi gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

29.1.12 Nga verifikimi i të dhënave bankare të dërguara nga “Tirana Bank”²² ka rezultuar se shtetasi N.L në datën 2.12.2014 ka depozituar *cash* në llogarinë e tij bankare shumën 20.000 euro dhe, po në të njëjtën datë, 2.12.2014, e ka transferuar këtë shumë në llogarinë e djalit të tij E.L (i cili e ka transferuar më pas këtë shumë, duke shtuar edhe vlerën 2.000 euro tek shitësi i apartamentit).

iii. Lidhur me të ardhurat e vjehrrit N.L nga shpërblimet e procesit gjyqësor

29.1.13 Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues vendimin gjyqësor nr. **, datë 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. **, datë 6.2.2008, të Komisionit të Shërbimit Civil.

29.1.14 Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se punëdhënësi Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me urdhrin nr. **, datë 25.9.2007, kishte vendosur masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil të shtetasit N.L. Ky i fundit ka

paraqitur ankim pranë Komisionit të Shërbimit Civil, i cili me vendimin nr. **, datë 6.2.2008, ka vendosur shfuqizimin e aktit, kthimin e z. L në vendin e punës, si dhe detyrimin për pagimin e tij nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në zbatim të vendimit.

29.1.15 Shtetasi N.L ka kërkuar ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor²³ pranë shoqërisë përbarimore ***, ku sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.11.2015, të kësaj shoqërie (të depozituar nga subjekti në deklaratën *Vetting*) janë ekzekutuar disa pagesa²⁴ në favor të z. N.L në zbatim të vendimit gjyqësor të mësipërm në vlerën totale 6.723.895 lekë.

29.1.16 Në dosje janë administruar disa çeqe bankare²⁵ dhe urdhër transfertë të lëshuara nga “Raiffeisen Bank”, ku evidentohen 4 pagesa të kryera nga shoqëria përbarimore në favor të z.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

²³ Për shkak se punëdhënësi Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk ka kryer ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor me vendimin nr. 16, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese është vendosur “Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ** datë 18.6.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. E publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 31.3.2014.

²⁴ Në datën 28.12.2011 është paguar shuma 1.118.006 lekë; në datën 30.3.2012 është paguar shuma 121.212 lekë; në datën 26.12.2013 është paguar shuma 320.153 lekë; në datën 26.4.2014 është paguar shuma 4.160.480 lekë; në datën 13.1.2015 është paguar shuma 136.210 lekë; në datën 13.5.2015 është paguar shuma 394.470 lekë; në datën 19.8.2015 është paguar shuma 473.364 lekë.

²⁵ (1) Çek i “Raiffeisen Bank”, i lëshuar në datën 4.4.2012 në emër të shtetasit N.L për shumën 100.800 lekë; (2) çek i “Raiffeisen Bank” datë 27.12.2013, në emër të shtetasit N.L për shumën 320.000 lekë dhe referencë e transaksionit datë 26.12.2013 me shumën 320.153 lekë; (3) çek i “Raiffeisen Bank” i lëshuar në datën 29.12.2011, në emër të shtetasit N.L për shumën 1.053.609 lekë dhe

N. L, deri në dhjetor të vitit 2014 (momenti i dhënies së dhuratës prej 20.000 euro) respektivisht shumat: (i) shuma 100.800 lekë në datën 4.4.2012, tërhequr nga llogaria e shoqërisë përmbarimore; (ii) shuma 320.000 lekë në datën 27.12.2013, tërhequr nga llogaria e shoqërisë përmbarimore; (iii) shuma 1.053.609 lekë në datën 29.12.2011; si dhe (iv) shuma 3.940.000 lekë në datën 30.6.2014.

29.1.17 Nga verifikimi i të dhënave bankare të dërguara nga “Raiffeisen Bank”²⁶ rezulton se pas kalimit të shumave sipas urdhrat të përmbarimit janë tërhequr pjesërisht fondet përpara datës së dhurimit të shumës. Shumat e tjera të kaluara janë investuar në bono thesari apo kanë qëndruar në llogari dhe nuk mund të jenë përdorur si burim për dhuratën 20.000 euro.

29.1.18 Për pasojë, në analizën financiare mbi burimet e kësaj shume janë përfshirë shumat e tërhequra përpara datës 2.12.2014:

- 253.000 lekë, tërhequr *cash* nga llogaria e N. L në “Raiffeisen Bank” në datën 30.12.2011;
- 500.000 lekë, tërhequr *cash* nga llogaria e N. L në “Raiffeisen Bank” në datën 30.6.2014;
- 100.800 lekë, tërhequr *cash* (me çek) nga llogaria e shoqërisë përmbarimore në datën 4.4.2012;
- 320.000 lekë, tërhequr *cash* (me çek) nga llogaria e shoqërisë përmbarimore në datën 27.12.2013.

iv. Lidhur me kursimet nga pagat e prindërve të bashkëshortit

29.1.19 Komisioni i ka kërkuar²⁷ subjektit të saktësojë se sa nga shuma e dhuruar është me kursime familjare të vjehrrit dhe sa është pjesa e mbuluar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion provues mbi të ardhurat nga paga e dhuruesit dhe të përcaktojë periudhën se kur janë krijuar këto kursime deri në datën 2.12.2014.

29.1.20 Subjekti ka shpjeguar²⁸ se: “Nga sa vjehrrit më ka treguar për shumën prej 20.000 euro kanë shërbyer: (1) kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat nga pagat, shpërblimet, interesat e tërhequra nga investimet në bono thesari, të mbajtura *cash* gjatë periudhës janar 2010 – 2.12.2014; dhe (2) të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në shumën rreth 1.100.000 lekë, ku gjatë periudhës 2011 – 2014 ka thyer çeket e dhënë nga zyra përmbarimore, konkretisht: çekun me nr. ***, datë 27.12.2013, në shumën 320.000 lekë dhe çekun me nr. ***, datë 4.4.2012, në shumën 100.800 lekë. Gjithashtu, gjatë periudhës 2011 – 2014, pas thyerjes së çekut të dhënë nga zyra përmbarimore dhe kalimit të fondit nga kjo e fundit, ka tërhequr nga llogaria e tij bankare pranë ‘Raiffeisen Bank’ shumat 235.000 lekë dhe 500.000 lekë”.

29.1.21 Më tej, subjekti ka shpjeguar se kursimet familjare të vjehrrit, që kanë shërbyer si pjesë e shumës së dhuruar, janë krijuar gjatë periudhës janar 2010 – 2.12.2014.

referencë e transaksionit bankar datë 28.12.2011 me shumë 1.118.006 lekë; (4) kërkesë për transfertë fondesh datë 30.6.2014 për kalimin e shumës 3.940.000 lekë nga shoqëria përmbarimore tek shtetasi N.L.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

²⁷ Përmes pyetësorit me email datë 15.2.2023.

²⁸ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 21.2.2023.

29.1.22 Subjekti ka depozituar dokumentacion²⁹ provues mbi të ardhurat e pagës të realizuara ndër vite nga bashkëshorti i saj E.L (në atë periudhë ka qenë i fejuari i saj), prindërit dhe motra e bashkëshortit, të cilët sipas shpjegimeve³⁰ të subjektit kanë jetuar bashkë në periudhën janar 2010 – 29.4.2013, ku familja e vjehrrit përbëhej nga 4 pjesëtar, N.L (vjehrrri), L.L (vjehrra), E.L (bashkëshorti) dhe E.L(kunata, e cila është martuar dhe larguar nga përbërja familjare në datën 29.4.2013) dhe në periudhën në vijim deri në datën 2.12.2014 përbërja familjare ka qenë me 3 anëtarë.

29.1.23 Subjekti ka depozituar certifikatën e përbërjes familjare të vjehrrit N.L të vitit 2010, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë, certifikatën e martesës së kumatës E.L, të lëshuar elektronikisht në datën 16.2.2013, si dhe certifikatën martesore të saj të lëshuar elektronikisht në datën 15.2.2023, ku subjekti Englantina Shehu ka lidhur martesë me shtetasin E.L në datën 15.7.2016.

29.1.24 Lidhur me investime në pasuri të luajtshme dhe paluajtshme të prindërve të bashkëshortit, për periudhën 2010 – 2.12.2014 (momenti i dhënies së shumës prej 20.000 euro), Komisioni i ka

²⁹ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 21.2.2023: (1) vërtetim me nr. ** prot., datë 3.2.2021, i lëshuar nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, e cila konfirmon se znj. L.L ka pasur të ardhura nga paga për periudhën 1.1.1994 – 30.11.2019; (2) vërtetim me nr. *** prot., datë 22.4.2021, lëshuar nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, e cila konfirmon se znj. L.L ka qenë punonjëse pranë këtij fakulteti dhe konfirmon shpërblimet dhe honorarët/orët jashtë orarit të marra nga ana e saj nga viti 1996 – 2020; (3) vërtetime të datës 12.2.2021, të lëshuara nga fondacioni “K.A.S”, i cili konfirmon se ka paguar znj. L. L në cilësinë e sekretares së qendrës shqiptaro-gjermane për trajnimin e gazetarëve ku ka mbajtur dhe paguar tatimin në burim për vitin 2013 (data 12.12.2013 me pagesë/honorar *neto* 300 euro) dhe për vitin 2014 (periudha janar - korrik 2014 me pagesë *neto* në total 720 euro); (4) nxjerrje llogarie e lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në datën 20.2.2023 për llogarinë e shtetasës L.L, për periudhën 2010 – 2014; (5) kartela e klientit L.L, e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, zyra e bonove të thesarit për periudhën 1.1.2009 – 2.12.2014, ku evidentohen investimet në bono thesari; (6) kërkesë për informacion datë 10.11.2022, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë mbi të ardhurat e shtetasve N.L dhe L.L; (7) vërtetim nr. *** prot., datë 14.11.2022, e Drejtorisë Rajonale të ISSH-së, e cila vërteton se z. N.L trajtohet me pension pleqërie me masë mujore 29.308 lekë, si dhe pension shtetëror suplementar pleqërie me masë mujore 13.258 lekë, për periudhën 5.11.2017 – 30.10.2022. Bashkëlidhur ndodhet librezja e punës së shtetasit N.L, ku evidentohen punësimet e tij duke filluar nga viti 1970; (8) vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nr.*** prot., datë 4.1.2018, i cili vërteton të ardhurat e realizuara nga punësimi i N.L: (a) pranë Nd.Komunal Prodhim M.N, për periudhën janar 1994 - dhjetor 1994; (b) pranë subjektit “*-” Ndërtimi, për periudhën tetor 1994 - nëntor 1994; (9) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, e cila konfirmon të ardhurat e realizuara nga shtetasin N.L për periudhën nëntor 1997 - tetor 2007; (10) vërtetim nr. *** prot., datë 14.11.2022, e Drejtorisë Rajonale të ISSH-së, i cili vërteton se znj. L.L trajtohet me pension pleqërie me masë mujore 32.732 lekë, për periudhën me datë fillimi 2.12.2019 – 30.10.2022. Bashkëlidhur ndodhet librezja e punës së shtetasës L.R, ku evidentohen punësimet e saj duke filluar nga viti 1977 e në vijim; (11) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, e cila vërteton të ardhurat e realizuara nga punësimi i shtetasës L.L pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, për periudhën janar 1994 - dhjetor 1994 – dhjetor 2018; (12) vërtetimin për bazën e vlerësuar me nr. *** prot., datë 22.11.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, e cila konfirmon të ardhurat e realizuara nga shtetasja E.L nga punësimi pranë universitetit “A.M” për periudhën 2012 – 2022, si dhe vërtetim për bazën e vlerësuar për periudhën tetor 2006 - dhjetor 2011; (13) lëvizjet e llogarisë bankare të shtetasit E.L pranë “Intesa Sanpaolo Bank” për periudhën 2009 – 2014; (13) lëvizjet e llogarisë bankare të shtetasit E.L në BKT për periudhën 2012 – 2014; (14) vërtetim për bazën e vlerësuar i vulosur elektronikisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në datën 18.2.2023 për shtetasin E.L, i cili konfirmon të ardhurat e realizuara nga punësimi pranë Media V në vitet 2012 – 2017; (15) vërtetim nr. *** prot., datë 5.2.2021, i zyrës përmbartimore ***, e cila konfirmon shumat e përfutuara nga z. N.L nga procedurat e ekzekutimit nga data 29.12.2011 deri më 26.9.2018, bashkëlidhur ndodhen kopje të çeqeve bankare me nr. ***, datë 29.12.2011, nr. ***, datë 4.4.2012, me nr. ***, datë 27.12.2013, si dhe kërkesë për transferim fondesh, datë 30.6.2014; (16) fatura të “Raiffeisen Bank”, të periudhës 2011 – 2014, për thyerjen e çeqeve bankare dhe tërheqjet e realizuara, ku evidentohen tërheqjet me çek e kryer nga z. N.L nga llogaria e “Raiffeisen Bank” në datën 30.12.2011 për shumën 1.053.709 lekë; datë 4.4.2012 për shumën 100.800 lekë dhe në datën 27.12.2013 për shumën 320.000 lekë, si dhe tërheqje nga llogaria bankare e z. N.L në “Raiffeisen Bank” shumat 500.000 lekë në datën 30.6.2014 dhe shuma 253.000 lekë në datën 30.12.2011; (17) nxjerrje llogarie pranë “Raiffeisen Bank” të shtetasit N.L, për periudhën 2010 – 2014; (18) kartela e klientit N.L, e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, zyra e bonove të thesarit për periudhën 1.1.2009 – 2.12.2014.

³⁰ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 21.2.2023.

kërkuar³¹ subjektit të depozitave dokumentacion për investime, në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, përfshirë edhe depozitat bankare apo likuiditetet që vjehri i saj N.L ka kryer në periudhën e krijimit të kursimeve deri në datën 2.12.2014, duke përcaktuar shumën e investimeve dhe burimet e ligjshme.

29.1.25 Subjekti ka shpjeguar³² se vjehri i saj N.L nuk ka kryer asnjë investim në pasuri të paluajtshme gjatë periudhës kur janë krijuar kursimet, gjatë 2010 deri më 2.12.2014.

29.1.26 Më tej, subjekti ka shpjeguar se: *“Të vetmet investime që janë kryer në këtë periudhë janë 2 investimet që ai ka bërë në bono thesari. Konkretisht: (1) në datën 30.12.2011 ka investuar në bono thesari shumën prej 800.500 lekësh. Si burim i kësaj shume ka shërbyer thyerja e çekut me nr. ***, datë 29.12.2011, të lëshuar nga zyra përmbarimore, në shumën 1.053.609 lekë, e cila i përkiste të ardhurave nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor; (2) në datën 30.6.2014 ka investuar në bono thesari shumën prej 3.401.112 lekësh. Si burim i kësaj shume ka shërbyer transferimi i fondit nga zyra përmbarimore në shumën 3.940.000 lekë, e cila i përkiste të ardhurave nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor”.*

29.1.27 Subjekti ka depozituar³³ si dokumentacion provues kartelën e klientit N.L të lëshuar nga Banka e Shqipërisë për periudhën 2009 – 2014, ku evidentohen investimet në bono thesari, si dhe lëvizjet në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank” nga janë transferuar të ardhurat për investimet në bono thesari.

29.1.28 Nga verifikimi i kryer përmes sistemit multifunksional të ASHK-së, si dhe informacioni i dërguar nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së Tirana Veri, Tirana Jug dhe Durrës³⁴ kanë rezultuar disa pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetasve N.L dhe L.L (prindërit e bashkëshortit), por nuk u evidentuan investime të kryera gjatë periudhës 2010 – 2014. Gjithashtu, nga informacioni i dërguar nga DPSHTRR-ja³⁵ nuk kanë rezultuar automjete të regjistruara në emër të shtetasve N dhe L.L.

29.1.29 Komisioni verifikoi gjendjen e likuiditeteve në bankë³⁶ nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, si dhe investimet e kryera në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë³⁷, e cila ka konfirmuar se shtetasit N.L dhe L.L kanë hapur llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit. Sipas informacionit mbi gjendjen e klientit N.L evidentohet: (i) investimi në bono thesari në ankandin e zhvilluar në datën 10.1.2012, si dhe shuma 800.000 lekë bono thesari, e emetuar në datën 10.1.2012 dhe maturuar në datën 10.1.2013; si dhe (ii) investimi në bono thesari në ankandin

³¹ Përmes pyetësorit me *email* datë 15.2.2023.

³² Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 21.2.2023.

³³ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 21.2.2023.

³⁴ (1) ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2023, shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2021 dhe shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2023; (2) ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2022 dhe shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2023; (3) ASHK Drejtoria Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2023; (4) ASHK Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë me shkresën nr. *** prot., datë 15.4.2021 dhe shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2023.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021.

³⁶ Shkresat: nr. *** prot., datë 17.3.2021, e “Alpha Bank”; nr. *** prot., datë 17.3.2021, e ABI Bank; nr. ON-A-*** prot., datë 19.3.2021, e Fibank; nr. *** prot., datë 30.3.2021, e BKT-së; nr. *** prot., datë 9.4.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”; nr. *** prot., datë 31.5.2021, e “Credins Bank”.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021.

e zhvilluar në datën 8.7.2014, si dhe shuma 3.400.000 lekë bono thesari me datë emetimi 10.7.2014 dhe datë maturimi 9.7.2015.

v. *Kursime të bashkëshortit gjatë viteve 2008 – 2014, në shumën 2.000 euro*

29.1.30 Komisioni ka analizuar të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit E.L (i cili gjatë periudhës 2008 – 2014 ka qenë me gjendje civile “beqar”)³⁸ nga punësimi pranë RTV O.N në periudhën 9.5.2008 - 20.11.2008 dhe punësimi pranë M. V sh.a. gjatë periudhës shkurt 2009 – dhjetor 2016.

29.1.31 Subjekti ka depozituar në deklaratën *Vetting* dokumentacionin provues:

- vërtetim datë 24.1.2017, i lëshuar nga RTV O.N, i cili konfirmon punësimin e shtetasit E.L për periudhën maj 2008 – nëntor 2008, si dhe ka dërguar të dhëna mbi pagën *bruto*;
- vërtetim datë 19.1.2017, i lëshuar nga V.P, i cili konfirmon se z. E.L është i punësuar pranë shoqërisë M. V sh.a. për periudhën shkurt 2009 – dhjetor 2016;
- *statement* i llogarisë bankare të E.L të lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank” për periudhën 2009 – 2016, ku evidentohen kreditimet e pagës në llogarinë e tij.

30. Analiza financiare mbi mundësitë familjare të z. N.L dhe bashkëshortit të subjektit për krijimin e shumës totale 22.000 euro deri më 2.12.2014

30.1 Nisur nga fakti se bashkëshorti i subjektit ka jetuar me prindërit e tij gjatë periudhës 2010 – 2014, u analizua mundësia e tyre për kursimet në shumat 20.000 euro dhe 2000 euro, të cilat janë deklaruar si burim për pagesën e këstit të parë, më 2.12.2014. Në analizë u morën në konsideratë elementet si vijon dhe janë paraqitur në tabelën vijuese:

- a. të ardhura nga paga të shtetasës L.L si punonjëse në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë për periudhën 2010 – 2014;
- b. të ardhura nga kontratat e shërbimit të shtetasës L.L me organizatën K.A.S për periudhën 2013 – 2014;
- c. tërheqje me çek (*cash*) nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në “Raiffeisen Bank”, trajtuar si më sipër;
- d. të ardhura nga pagat e shtetasit E.L për vitet 2012 – 2014, për të cilat provohen me *statement* bankar, si dhe vërtetim nga punëdhënësi mbi pagën *bruto* dhe *neto* të përfituar. Duke qenë se nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë provuar sigurime të paguara për periudhën 2012 e në vijim, në analizë janë konsideruar të ardhura të ligjshme vetëm për këtë periudhë;
- e. shpenzime jetike sipas standardit të ILDKPKI-së për periudhën 2010 – 2014 janë përlllogaritur për tre persona, prindërit dhe bashkëshorti i subjektit. Në përgjigje të pyetësorit, bashkëshorti ka pretenduar se deri në muajin prill 2013 në familje ka jetuar dhe ka siguruar të ardhura nga punësimi edhe motra e tij. Në referencë të deklaratimit në deklaratën *Vetting*, ku si burim janë përmendur kursimet e prindërve, të ardhurat e motrës³⁹ nuk janë marrë në konsideratë. Gjithashtu, nuk është përfshirë edhe në shpenzimet jetike për periudhën.

³⁸ Lidhur martesë me subjektin në datën 15.7.2016.

³⁹ Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se motra ka qenë pedagoge në universitetin “A.M”.

Tabela e analizës financiare mbi mundësitë e krijimit të shumës 22.000 euro

Përshkrimi	Vitet 2010 – 2014
Të ardhura L. L Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	3 471 169
Të ardhura L. L nga K.A.S	142 942
Të ardhura E. L 2012 – 2014	1 415 583
Tërheqje <i>cash</i> nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor	1 173 800
Të ardhura totale	6 203 494
Shpenzime jetike	2 266 431
Mundësia e krijimit të shumës 22.000 euro	3 082 420
Rezultati financiar	854 644

- Nga analiza financiare e kryer duket se familja e bashkëshortit të subjektit ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës 22.000 euro, për pagesën e kështit të parë.

Lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit

31. Në pyetësoin standard subjekti ka deklaruar në mënyrë të detajuar shpenzimet e kryera për arredimin e shtëpisë dhe pajisjeve shtëpiake⁴⁰, të cilat janë reflektuar në analizën financiare.

Vlerësimi i Komisionit për pasurinë apartament

32. Nga hetimi i kryer dhe analizimi i burimeve të krijimit u konstatua se:
- Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë apartament, në përputhje me ligjin.
 - Ka disponuar burime të ligjshme për blerjen e apartamentit në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
33. **Depozitë kursimi⁴¹ në “Intesa Sanpaolo Bank”,** krijuar më 1.1.2014, me gjendje në vlerën 462.327 lekë (në datën e dorëzimit). Pjesa takuese: 100 %. Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga, shpërblimet, honorarët dhe interesi bankar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

33.1 “Intesa Sanpaolo Bank”⁴² ka informuar se shtetasja Englantina Shehu nuk rezulton të ketë pasur marrëdhënie me bankën.

⁴⁰ Në pyetësoin standard subjekti ka deklaruar: (1) nga subjekti shitës “Personi fizik A.F, me nr. NUIS K***Q” ka blerë: dollap me çmim 41.000 lekë, komodina 2 me çmim 8.000 lekë; krevat + dyshek me çmim 32.000 lekë, paret (mbajtëse tv) me çmim 5.000 lekë, tavolinë me 4 karrige me çmim 34.000 lekë dhe kuzhinë gatimi me çmim 180.000 lekë; (2) pranë N me nr. NUIS ***B ka blerë lavatriçe LG F **B*ND me çmim 49.900 lekë dhe hekur Boch TDA***, me çmim 4.990 lekë; (3) tek subjekti shitës shoqëria “*** sh.p.k., me nr. NUIS K***F subjekti ka blerë: frigorifer Electrolux EN *** AOX, me çmim 39.000 lekë, furrë inkaso AEG, EOB *** DOX me çmim 34.000 lekë; pianurë EHF *** FOK, me çmim 25.000 lekë dhe aspirator FABER 2740 BR/X A 60 me çmim 8.000 lekë; (4) tek mobileri “Tirana”, autostrada Tiranë-Durrës, km 7 ka blerë kënd (divan) me çmim 450 euro; (5) tek subjekti shitës “Personi fizik E.B, me nr. NUIS K***C” ka blerë kondicioner “Mitsubishi Inverter” 12.000 BTU/MSZ – HS35VA me çmim 630 euro; (6) pranë AZA Elektroshtëpiake, me nr. NUIS K***V ka blerë televizor SUNNY TV 14443, me çmim 16.990.

⁴¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank” të datës 23.1.2017, për Englantina Shehu, gjendja e depozitës në datën 9.1.2017 është 462.327 lekë.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021.

33.2 Referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.7.2017 (të administruar në dosjen e ILDKPKI-së), të “Intesa Sanpaolo Bank”, rezulton se subjekti Englantina Shehu ka pasur llogari pranë kësaj banke, ku sipas përmbledhësës së llogarisë në datën 25.1.2017 gjendja e llogarisë rezulton në shumën 463.334 lekë. Gjithashtu, subjekti ka depozituar *statement* të llogarisë së saj bankare për periudhën 1.1.2014 – 23.1.2017.

33.3 Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar “Intesa Sanpaolo Bank”, përmes postës elektronike me *email* datë 1.3.2023, të saktësojë informacionin e dërguar prej saj, e cila ka dërguar⁴³ *statement* të të gjitha llogarive bankare të subjektit pranë kësaj banke, ku evidentohet gjendja e llogarisë në datën 9.1.2017, në shumën 462.327 lekë, e cila përputhet me deklarinimin e subjektit.

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

34. Llogari⁴⁴ në “Tirana Bank”, krijuar më 15.3.2015, me gjendje 1.000 lekë (në momentin e dorëzimit të deklaratës). Pjesa takuese: 100 %.

34.1 Kjo llogari është krijuar në momentin e disbursimit të kredisë në “Tirana Bank”, me qëllim pagimin e kësteve mujore të kredisë.

34.2 Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

- Nga hetimi i kryer, deklarimi përputhet me dokumentacionin e ardhur nga “Tirana Bank”.

35. Kartë krediti⁴⁵ në “Intesa Sanpaolo Bank”, çelur më 1.1.2015, në shumën 10.000 lekë, me gjendje në datën e dorëzimit të deklaratës në vlerën 1.007 lekë. Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

- Nga hetimi i kryer, deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

DETYRIME FINANCIARE

36. Kredi bankare⁴⁶ për blerje apartament banimi në rrugën “D.B”, Tiranë, në shumën 4.200.000 lekë, marrë me kontratën nr. *, datë 13.3.2015, me afat 15 vjet. Shuma e detyrimit e mbetur pa shlyer 3.889.439 lekë.**

⁴³ Informacion i dërguar nga “Intesa Sanpaolo Bank” përmes postës elektronike me *email* datë 7.3.2023.

⁴⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Tirana Bank” për shtetasen E.Sh, gjendja e llogarisë në datën 24.1.2017 është 1.000 lekë.

⁴⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie “Intesa Sanpaolo Bank” datë 23.1.2017 për shtetasen Englantina Shehu, gjendja e llogarisë së kartës së kreditit është 1.007 lekë.

⁴⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë kredie nr. ***, datë 13.3.2015, me palë kredidhënëse “Tirana Bank” dhe palë kredimarrëse Englantina Shehu dhe E.L për kredi në shumën 4.200.000 lekë. Kohëzgjatja 15 vjet. Kredia do të sigurohet nga hipoteka mbi pasurinë apartament me sip. 62.3 m², rruga “D.B”, Tiranë, në pronësi të N.D; (2) konfirmim nga “Tirana Bank” datë 24.1.2017, e cila konfirmon se Englantina Shehu ka marrë kredi dhe gjendja e detyrimit në datën 24.1.2017 është 3.889.439 lekë.

36.1 “Tirana Bank”⁴⁷ ka konfirmuar se shtetasja Englantina Shehu ka llogari pranë bankës në monedhën lekë dhe është kredimarrëse aktive për periudhën 2015 – 13.1.2021.

36.2 Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore nga viti 2015 e në vijim, tek rubrika e detyrimeve financiare subjekti ka deklaruar kredinë e marrë, si dhe detyrimin e mbetur të pashlyer çdo vit.

- Nga hetimi i kryer, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga “Tirana Bank”.

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT – E.L

37. Depozitë kursimi⁴⁸ në BKT në shumën 401.700 lekë, çelur në vitin 2015

37.1 Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga, shpërblimet, honorarët dhe interesi bankar. Pjesa takuese: 100%.

37.2 BKT-ja⁴⁹ ka informuar se shtetasi E.L ka llogari page në monedhën lekë të lidhur me kartë debiti. Bashkëlidhur shkresës ndodhet pasqyra e llogarisë së depozitës bankare.

37.3 Kjo llogari depozite është çelur në datën 11.8.2015 në shumën 200.000 lekë dhe në datën 9.9.2016 është kredituar edhe shuma 200.000 lekë. Gjendja e depozitës në momentin e deklarimit ka qenë 401.700 lekë.

- Nga hetimi i kryer përputhet deklarimi me dokumentacionin e ardhur nga BKT-ja.

38. Llogari page⁵⁰ në BKT, me gjendje në vlerën 40.290 lekë (në ditën e dorëzimit të deklaratës). Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.

38.1 BKT-ja⁵¹ ka konfirmuar llogarinë e pagës së shtetasit E.L në monedhën lekë të lidhur me kartë debiti. Bashkëlidhur shkresës ndodhet pasqyra e llogarisë, ku evidentohen kreditimet e pagës nga punëdhënësi “M.V” nga viti 2013 e në vijim.

- Nga hetimi i kryer përputhet deklarimi me dokumentacionin e ardhur nga banka.

39. Automjet⁵² tip “Mercedes-Benz A Class”, blerë në vitin 2015, në shumën 6.500 euro

39.1 Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga si gazetar gjatë viteve 2007 – 2014, në TV “V.P” dhe TV “O.N”; gazetar pranë agjencisë kosovare “T”; gazetar në revistën “F”; gazetar me kohë të pjesshme në buletin “***”; intervista dhe opinione në gazetatat “Sh”, “Sh”, “S”, “T”, “K”, “E.J.O”; honorarë referues në revista shkencore të Departamentit të Gazetarisë dhe

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

⁴⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nr. ** prot., datë 20.1.2017, nga BKT-ja, sipas të cilit shtetasi E.L ka llogari me gjendje në vlerën 401.700 lekë.

⁴⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

⁵⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 20.1.2017, sipas së cilës shtetasi E.L ka llogari me gjendje në datën 20.1.2017 në vlerën 40.290 lekë.

⁵¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

⁵² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.7.2015, me palë shitëse D.D dhe palë blerëse E.L, për automjetin tip “Mercedes-Benz”, vlera 6.500 euro + deklaratë doganore; (2) certifikatë pronësie dhe leje qarkullimi për automjetin me targa AA *** MA, në pronësi të shtetasit E.L.

Komunikimit në UT; pedagog me kohë të pjesshme në universitetin “K”; monitorues për disa vite i organizatës ndërkombëtare “****” për zgjedhjet në Ukrainë; vëzhgues i zgjedhjeve në Shqipëri nga organizata joqeveritare “****”. Fituar me kontratë shitblerjeje nr.***, datë 15.7.2015.

Hetimi i kryer nga Komisioni

40. DPSHTRR-ja⁵³ ka informuar se znj. Englantina Shehu ka të regjistruar automjetin me targa AA *** MA, ndërkohë, nga aktet në dosje, ky automjet figuron i regjistruar në pronësi të shtetasit E.L (duket se ka një gabim material në shkresën e dërguar nga DPSHTRR-ja).

40.1 Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se shtetasi E.L përmes kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.7.2015, ka blerë nga shitësi D.D një automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2007, kundrejt çmimit 6.500 euro, i cili është likuiduar midis palëve jashtë zyrës noteriale.

40.2 Nga dosja e automjetit rezulton se shitësi D.D e ka blerë këtë automjet në Gjermani në vlerën 1.250 euro + zhdoganimi në vlerën 165.923 lekë (bazuar në vlerën statistikore prej 829.623 lekësh) të kryer në datën 15.7.2015.

40.3 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit të rivlerësimit me shitësin e automjetit D.D dhe nga përgjigjja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁵⁴, ku subjekti ka ushtruar funksionin e prokurores, nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të këtij shtetasi.

Burimi i krijimit

41. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit: (i) të ardhura nga paga si gazetar gjatë viteve 2007 – 2014 në TV “V.P” dhe TV “O.N”; (ii) gazetar pranë agjencisë kosovare “T”, (iii) gazetar në revistën “F”, (iv) gazetar me kohë të pjesshme në buletin “****”, intervista dhe opinione në gazetat “Sh”, “Sh”, “S”, “T”, “K” dhe “E.J. O”; (v) honorarë referues në revista shkencore të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në UT; (vi) pedagog me kohë të pjesshme në universitetin “K”, monitorues për disa vite i organizatës ndërkombëtare “****” për zgjedhjet në Ukrainë; (vii) vëzhgues i zgjedhjeve në Shqipëri nga organizata joqeveritare “****”.

Analiza financiare mbi burimet e ligjshme

42. Komisioni kreu analizën financiare për mundësitë e bashkëshortit të subjektit për blerjen e automjetit në korrik të vitit 2015. Në analizën financiare u përllogaritën të ardhurat nga pagat nga janari 2015 deri në korrik 2015. Duke qenë se bashkëshorti nuk ka qenë subjekt i deklaramit të pasurive përpara vitit 2015, në analizë u mor në konsideratë edhe mundësia për kursim nga pagat në vite (kumulative⁵⁵) referuar burimit të deklaramit nga ana e tij për periudhën 2012 – 2014, ku në total deri në korrik 2015 shkojnë në shumën 924.553 lekë.

⁵³ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021.

⁵⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.3.2023.

⁵⁵ Mundësia për kursim për periudhën përpara vitit 2015 është rezultat i të ardhurave minus shpenzimet dhe krijimit të shumës 2.000 euro për pagesën e kështit të apartamentit vetëm për bashkëshortin e subjektit.

42.1 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se në korrik të vitit 2015 bashkëshorti ka hapur edhe një depozitë në shumën 200.000 lekë (trajtuar në pikën 37). Edhe kjo shumë u përllorarit në analizën financiare.

42.2 Shpenzimet e jetesës për periudhën dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar gjatë hetimit për periudhën janar – korrik 2015 janë përllorarit vetëm për pjesën takuese të bashkëshortit të subjektit, kjo pasi ky automjet është deklaruar 100% i bashkëshortit dhe burim vetëm të ardhurat nga pagat e tij si individ.

Tabela e analizës për mundësinë e blerjes së automjetit

Përshkrimi	Janar – 15 korrik 2015
PASURI	972 723
Automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2015	894 725
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	77 998
DETYRIME	-
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	972 723
TË ARDHURA	924 553
Të ardhura nga paga e bashkëshortit janar – korrik 2015	563 000
Kursime kumulative 2012 – 2014	361 553
SHPENZIME	376 698
Shpenzime jetese	121 483
Shpenzime udhëtimi TIMS	27 530
Shpenzime mobilimi	136 416
Shpenzime - këste kredie “Tirana Bank”	91 268
Rezultati financiar	- 424 867

Konstatime të Komisionit për automjetin

43. Nga hetimi i kryer për këtë pasuri duket se:

- Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga DPSHTRR-ja.
- Nga analiza financiare e kryer mbi mundësitë e bashkëshortit për blerjen e automjetit ka rezultuar një balancë negative në shumën 424.867 lekë.
- **Në lidhje me këtë balancë negative, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

44. Subjekti në prapësime ka depozituar dokumentacion mbështetës⁵⁶ mbi të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit për periudhën shkurt 2009 – mars 2012, duke pretenduar se nga ana e Komisionit

⁵⁶ (1) Kërkesë datë 6.2.2013 dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; (2) kërkesë datë 17.2.2023 dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.2.2023, e Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë; (3) vërtetim datë 23.3.2023, i shoqërisë “M.V” sh.a.

duhet të merret në konsideratë dhe të përfshihen në analizën financiare të gjitha të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti gjatë kësaj periudhe nga shoqëria “M.V” sh.a.

44.1 Më tej, subjekti, ndër të tjera, ka prapësuar dhe shpjeguar se: *“Në sintezë të fakteve, akteve të sipërcituara, si dhe legjislacionit të posaçëm, vlerësoj se në rastin konkret nga ana e Komisionit duhet të merret në konsideratë dhe të përfshihen në analizën financiare të gjitha të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti im gjatë periudhës shkurt 2009 – mars 2012. Kjo bazuar në:*

Së pari, të gjitha të ardhurat janë përfutuar nëpërmjet sistemit bankar. Me përshkrimin përkatës. Paga nëpërmjet sistemit bankar krijon sigurinë tek përfutuesi për ligjshmërinë e të ardhurave.

Së dyti, shoqëria ‘M.V’ sh.a., në të dy vërtetimet e lëshuara prej saj ka paraqitur faktin se prej kësaj të fundit janë mbajtur dhe paguar detyrimet tatimore: i. Në vërtetimin e datës 19.1.2017, ka pasqyruar të ardhurat bruto dhe neto që ka përfutuar bashkëshorti im. Diferenca ndërmjet tyre paraqet detyrimet tatimore të mbajtura dhe të paguara. ii. Në vërtetimin e datës 23.3.2023 ka pranuar që ka mbajtur dhe ka paguar tatimin në burim sipas legjislacionit në fuqi.

Së treti, organet tatimore për periudhën 2009 – 2012 pranojnë se subjekti ‘M.V’ sh.a. në vitin 2009 ka derdhur dhe paguar tatimin në burim. Ndërkohë, për periudhën tjetër nuk gjenerojnë të dhëna, por na adresojnë tek shoqëria që e ka mbajtur. Gjithashtu, ato na bëjnë me dije se nuk mund të identifikohet individ i llogaritësi të cilin paguhet tatimi në burim, pasi ai paguhet në total dhe jo për çdo individ apo shërbim.

Së katërti, referuar legjislacionit të posaçëm, detyrimin për mbajtjen dhe pagimin e tatimit në burim e ka pasur shoqëria ‘M.V’ sh.a. Në kushtet kur të ardhurat e përfutuar nga bashkëshorti nuk kalonin kufirin ligjor për plotësimin e deklaratës DIVA, sipas legjislacionit të posaçëm, ai nuk ka pasur detyrim ligjor për plotësimin e deklaratës personale për të ardhurat pranë organeve tatimore.

Së pesti, përfshirja dhe llogaritja e të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti gjatë periudhës shkurt 2009 – mars 2012 mbështetet edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.

Vlerësimi i Komisionit për automjetin

45. Komisioni, bazuar në provat e depozituara nga subjekti në prapësime, nga analizimi i të ardhurave të ligjshme të bashkëshortit në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për periudhën 2010 – 2014, ka përllogaritur në mënyrë kumulative këto të ardhura të cilat rezultojnë në shumën 1.569.019 lekë, që duke u reflektuar në analizë financiare do të rezultonte një balancë pozitive.

45.1 Përfundimisht, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar saktë pasurinë automjet dhe ka disponuar burime të ligjshme në kuptim të ligjit.

VERIFIKIME TË TJERA

46. Adresat e vendbanimit të deklaruara ndër vite

46.1 Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit në DPV-në e vitit 2013 para fillimit të detyrës⁵⁷ deri në vitin 2014, subjekti ka deklaruar si adresë: Njësia Bashkiake Nr. *, rr. "M. Sh", Kompleksi K **, Tiranë.

46.2 Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar⁵⁸ se që prej datës 8.11.2013 (data e dekretit për stazhin profesional) dhe deri në dhjetor të vitit 2014 ka banuar në këtë adresë në apartamentin në pronësi të motrës së saj E.B, ku ka bashkëjetuar me shoqen e universitetit E.S (Xh) dhe kanë ndarë shpenzimet e qirasë së bashku në vlerën 15.000 lekë (7.500 lekë/secila).

46.3 Nga verifikimi i aktit të pronësisë së apartamentit të shtetases E.B evidentohet se kjo pasuri është regjistruar në pronësi të motrës së subjektit, znj. E.B, në prill 2013, periudhë para emërimit në detyrë të subjektit, nëntor 2014.

46.4 Në pyetësin standard subjekti ka shpjeguar se në muajt janar - mars të vitit 2015 ka banuar në apartamentin në pronësi të vjehrrit dhe vjehrrës, të ndodhur në adresën: rr. "P.D", p. **, shk. *, ap. **, Tiranë. Në këtë apartament subjekti nuk ka paguar qira, por ka qëndruar si e fejuara e djalit të tyre, ku gjatë kësaj periudhe ka përbaluar vetë shpenzimet për jetesë, me të ardhurat nga paga.

46.5 Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të ardhur nga ASHK Tiranë Veri⁵⁹ rezulton se kjo banesë është blerë nga shtetasi N.L (vjehri i subjektit) përmes procedurave të privatizimit të banesave shtetërore me Ndërmarrjen Komunale Banesa Tiranë, në datën 25.8.1993.

46.6 Në DPV-në e vitit 2015 dhe në vijim subjekti ka deklaruar si adresë banimi lagjja "D.B", kompleksi *** (prapa restorant "Gj") Tiranë, e cila nga verifikimi i kryer përkon me adresën e apartamentit të blerë nga subjekti në shkurt të vitit 2015.

46.7 Nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan problematika lidhur me adresat e banimit të deklaruar ndërsa vite.

47. Të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, të verifikuara nga Komisioni

47.1 Nga të dhënat e sistemit TIMS⁶⁰ evidentohet se subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit kryesisht me automjetin në pronësi të bashkëshortit të saj, me targa AA *** MA, ose me furgon/autobus.

47.2 Nga hetimi i kryer duket se deklarimi i subjektit në pyetësin standard lidhur me udhëtimet e kryera dhe personat që e kanë shoqëruar në udhëtim përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga sistemi TIMS.

48. Lidhur me shpenzimet e transportit

48.1 Nisur nga fakti se nga viti 2013 subjekti i rivlerësimit E.Sh ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ndërkohë gjatë kësaj periudhe

⁵⁷ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 18.12.2013.

⁵⁸ Në pyetësin standard.

⁵⁹ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2022.

⁶⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

ka qenë me banim në qytetin e Tiranës, Komisioni i ka kërkuar⁶¹ subjektit të deklarojë me çfarë mjeti ka udhëtuar dhe vlerën e shpenzimeve të transportit për çdo vit Tiranë - Fier dhe anasjelltas.

48.2 Subjekti ka dhënë shpjegimet⁶² përkatëse lidhur me vlerën e shpenzimeve të transportit të kryera prej saj, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit.

49. Analiza e përgjithshme financiare për periudhën 2014 – 2016

49.1 Në analizën financiare u morën në konsideratë:

- Të ardhurat e subjektit nga pagat në detyrën e prokurores janë pasqyruar *neto* sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni përkatës, administruar në dosjen hetimore të subjektit.
- Të ardhurat e bashkëshortit janë pasqyruar bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje për të cilat provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të ligjit.
- Dhurata prej 20.000 euro nga babai i bashkëshortit, dhënë me transfertë bankare.

49.2 Në lidhje me shpenzimet:

- Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për vitin 2014 për subjektin dhe bashkëshortin, duke filluar nga janari i vitit 2015, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.
- Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit janë bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje - dalje nëpërmjet të dhënave të sistemit TIMS për subjektin e rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan/plotësuan me deklaratimet e subjektit. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit.
- Shpenzimet për blerjen e automjetit u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin e administruar nga institucionet përkatëse.
- Shpenzimet për mobilim dhe rinovime janë përlllogaritur referuar deklaratimeve periodike, deklaratimeve gjatë hetimit.
- Shpenzimet për këstet e kredive janë përlllogaritur sipas shumave të debituar në llogarinë bankare për vitin 2015.
- Shpenzimet për transportin Tiranë - Fier dhe shpenzimet e qirasë për vitin 2014 janë llogaritur në bazë të deklaratimit të subjektit.

Tabela e përgjithshme e analizës financiare për periudhën 2014 – 2016

Përshkrimi	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
PASURI	3 313 413	5 279 720	369 069
Apartament 62.3 m ² , blerë në vitin 2015	3 082 420	4 129 500	
Automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2015		894 725	
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	230 993	255 495	369 069

⁶¹ Përmes pyetësorit me *email* datë 1.3.2023.

⁶² Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.3.2023.

Likuiditete gjendje	239 508	495 003	864 072
DETYRIME	-	4 200 000	-
Kredi "Tirana Bank"		4 200 000	
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	3 313 413	1 079 720	369 069
TË ARDHURA	4 585 848	3 776 445	2 187 071
Të ardhura nga paga e subjektit	1 166 648	1 395 926	1 136 871
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	617 000	2 380 519	1 050 200
Dhuratë nga N. L.	2 802 200		
SHPENZIME	684 212	1 331 011	1 078 946
Shpenzime jetese	219 998	448 552	470 184
Shpenzime udhëtimi TIMS	18 214	142 881	17 585
Shpenzime transporti Tiranë - Fier	106 000	107 000	56 000
Shpenzime qiraje	90 000		
Shpenzime mobilimi	250 000	272 833	85 220
Shpenzime - këste kredie "Tirana Bank"		359 746	449 957
Rezultati financiar	588 223	1 365 714	739 056

Vlerësimi përfundimtar i kriterit të pasurisë

50. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rast në situatë konflikti interesi.

B. KONTROLLI I FIGURËS

51. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.
52. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport⁶³ në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së znj. Englantina B.Shehu.*

Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës

⁶³ Raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

53. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja dhe nga informacioni i ardhur ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna shtesë.

53.1 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

53.2 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

54. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit⁶⁴ të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

55. Raporti i KLP-së është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të dhënave në Drejtorinë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

56. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

56.1 Formulari paraqitet i nënshkruar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

56.2 Nga analizimi i tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga znj. Englantina Shehu nuk evidentohen problematika që kanë të bëjnë me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE PENALE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

⁶⁴ Raporti nr. *** prot., datë 9.5.2022, i miratuar me vendimin nr. **, datë 9.5.2022, të KLP-së..

57. Rezulton se subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu për periudhën e rivlerësimit ka qenë me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

57.1 Nga shorti i hedhur u përzgjedhën në mënyrë rastësore pesë dosje penale, të cilat u analizuan nga Komisioni dhe për dosjen 2 është evidentuar si në vijim:

Dosja nr. 2 – vendim “Për pushimin e çështjes penale”, datë 5.5.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo çështje penale është hetuar nga prokurorja Englantina Shehu. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, prokurorja Englantina Shehu e ka konsideruar të përfunduar hetimin paraprak dhe në datën 5.5.2015, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: *“Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014. Vendimi i njoftohet personit të interesuar. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier ose tek prokurori më i lartë”*.

Vlerësimi i Komisionit për pesë dosjet e vëzhguara

58. Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional. Për njërën nga dosjet, konkretisht dosja nr. 2, që i përket procedimit penal nr. ***, i regjistruar në datën 26.11.2014, evidentohet se vendimi i subjektit, marrë në datën 23.2.2015 për zgjatjen e afatit të hetimit, nuk rezulton t’i jetë njoftuar personave nën hetim, në përputhje me parashikimet e nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

59. Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjekti, përmes prapësimeve të saj, ka shpjeguar se pas referimit të materialit kallëzues, në datën 5.5.2014 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe shënimin në regjistër të emrit të shtetasve M.I dhe Sh.K.

59.1 Pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, subjekti ka vlerësuar se ishte e domosdoshme që në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm të kryheshin hetime të tjera dhe, në këto kushte, në datën 23.2.2015 ka marrë vendimin për zgjatjen e afatit hetimor, ku në këtë vendim ka vendosur edhe njoftimin e personave nën hetim, si dhe të drejtën e ankimit.

59.2 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në datën 26.2.2015 ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, të cilat lidheshin pikërisht me personat nën hetim, si pyetja e tyre dhe ballafaqimi i tyre, ku kjo dosje i është dhënë oficerit të policisë gjyqësore dhe bashkë me të ishte edhe vendimi për zgjatjen e afatit hetimor, i datës 23.2.2015.

59.3 Në prapësimet e saj, subjekti ka argumentuar se në bazë të nenit 140 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, një ndër mënyrat e njoftimit të akteve është edhe nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore. Kështu, për njoftimin e këtij vendimi, në kushtet kur do të kryheshin veprime hetimore me personat nën hetim, u ngarkua oficeri i policisë gjyqësore.

59.4 Më tej, subjekti ka shpjeguar se mungesa e nënshkrimit të personave nën hetim në vendimin “Për zgjatjen e afatit hetimor” nuk nënkupton që këta të fundit nuk janë njoftuar, pasi këta shtetas janë thirrur nga oficeri i policisë gjyqësore dhe kanë qenë subjekte të veprimeve procedurale, si dhe duke qenë punonjës policie kanë pasur njohuri për legjislacionin procedural penal.

59.5 Megjithatë, edhe në rast se personat nën hetim nuk do mund të ishin njoftuar me vendimin për zgjatjen e afatit hetimor, ky fakt nuk cenon asnjë nga të drejtat e tyre procedurale dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë, pasi vendimi i fillon efektet e tij në momentin që pala merr dijëni. Pra, mosnjoftimi i tij, pavarësisht datës se kur është marrë, nuk cenon të drejtën që ligji i garanton personit nën hetim për t’u ankuar ndaj këtij vendimi. Kjo pasi:

59.6 *Së pari*, ligji nuk e kushtëzon të drejtën e personit nën hetim për të ushtruar ankim ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve brenda një faze të caktuar procedurale, por e lidh atë me momentin e marrjes dijëni për këtë vendim.

59.7 *Së dyti*, referuar nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale, për mungesën e njoftimit të vendimit për zgjatjen e afatit hetimor, legjislatori nuk ka parashikuar asnjë sanksion, aq më shumë me pasoje pavlefshmërie. Referuar nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji, ndërsa një pasojë e tillë nuk i atribuohet vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve kur ky nuk i njoftohet në kohë personave nën hetim.

59.8 *Së treti*, personat nën hetim nuk rezultojnë të kenë ankimuar ligjshmërinë apo bazueshmërinë e vendimeve të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve as brenda afatit 10-ditor nga marrja dijëni dhe as pas pushimit të hetimeve përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Subjekti ka depozituar aktet⁶⁵ procedurale që mbështesin shpjegimet e sipërcituara.

Vlerësimi i Komisionit lidhur me dosjen nr. 2

60. Në analizë të shpjegime të dhëna nga subjekti, pavarësisht faktit se palët kanë marrë dijëni mbi zgjatjen e afatit hetimor në vijim, përmes veprimeve hetimore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, Komisioni vëren se njoftimi nuk është kryer sipas përcaktimeve të nenit 324, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale, ku vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet personave nën hetim. Komisioni vlerëson se kjo mangësi e konstatuar çmohet e pamjaftueshme dhe nuk cenon aftësitë profesionale të subjektit.

TË DHËNA NGA BURIMET ARKIVORE

61. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nuk rezultojnë të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Englantina Shehu.

⁶⁵ Urdhër datë 5.12.2014, për kryerjen e veprimeve hetimore; vendim datë 23.2.2015, për zgjatjen e afatit hetimor; vendim datë 26.2.2015, për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore; procesverbal i ballafaqimit datë 17.3.2015; procesverbal datë 27.3.2015, për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime; shkresë nr. ** prot., datë 5.5.2018, e SHÇBA-së drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

61.1 Ndaj subjektit të rivlerësimit Englantina Shehu ka disa materiale hetimore të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, konkretisht:

- Kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018

61.2 Me vendimin datë 24.10.2018 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. *** i vitit 2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

- Kallëzimet penale nr. ** dhe nr. *** të vitit 2020

61.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.1.2021, ka informuar se në datën 6.11.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit.

- Kallëzimi penal nr. *** i vitit 2019

61.4 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin datë 31.7.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

- Kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018

61.5 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 1.3.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

61.6 Ndaj subjektit të rivlerësimit rezultojnë të jenë regjistruar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar disa kallëzime penale (nr. ***i vitit 2015, nr. *** i vitit 2015, nr. * i vitit 2018 dhe nr. * i vitit 2019) dhe pas verifikimit të materialit kallëzues është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

61.7 Pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së prokurores Englantina Shehu, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, e cila për vitet 2014, 2015 dhe 2016 e ka vlerësuar në nivel “shumë mirë”.

ANALIZA E GJETJEVE

62. Nga analizimi i pesë dosjeve të zgjedhura me short, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka rezultuar si vijon:

63. Aftësitë profesionale

63.1 Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Englantina Shehu, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

63.2 Subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara janë të kuptueshme, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi pasqyrimit të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimit të rrethanave të faktit, ku formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurorja. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

64. Aftësitë organizative

64.1 Subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu në periudhën e rivlerësimit ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

64.2 Prokurorja ka kryer detyrat e saj në përputhje me pikat 2 dhe 2.1 të urdhërit nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurorja e çështjes.

64.3 Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të tij ligjore, konstatohet se prokurorja ka përballuar ngarkesë pune normale gjatë periudhës së rivlerësimit. Nga analiza e dosjeve të përzgjedhura, qëndrimi i subjektit është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim.

64.4 Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurorja ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

65. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

65.1 Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

65.2 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu dhe nga dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

66. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

66.1 Nga dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

66.2 Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, duke marrë pjesë në 15 seminare. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe pjesëmarrjen në dy trajnime të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

DENONCIME

67. Për subjektin e rivlerësimit Englantina Shehu janë depozituar 13 denoncime nga publiku, ku 3 prej tyre janë të përsëritura, pra në total janë 10 denoncime, të cilat u verifikuan nga Komisioni, nga ku rezultoi se:

- 4 prej denoncimeve nuk përmbanin fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk u evidentua ndonjë pretendim apo shkelje konkrete e kryer nga subjekti.
- Për 4 denoncime të tjera janë ngritur pretendime për vendimmarrje të padrejtë, të cilat lidhen me themelin e çështjes dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

68. Denoncim nr. *** prot., datë 1.12.2017, i shtetasit N.D

68.1 Në denoncimin e tij, ky shtetas ka pretenduar se subjekti Englantina Shehu dhe prokurorë të tjerë në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë marrë favore nga ish-kryetari i komunës, ish-prefekti dhe ish-drejtori i ZVRPP-së, duke dhënë vendime pa u bazuar në ligj e prova, si dhe kanë zvarritur procesin.

68.2 Denoncuesi ka pretenduar se janë 21 vendime të dhëna nga disa prokurorë për zvarritje të proceseve, të cilat i ka depozituar pranë Komisionit. Nga verifikimi i këtyre vendimeve ka rezultuar se 7 prej tyre ishin vendime⁶⁶ të dhëna nga prokurorja Englantina Shehu, e cila ka

⁶⁶ (1) Vendimi datë 27.11.2014, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, të regjistruar në datën 4.11.2014, për veprat penale “shpërdorim detyre”, “falsifikim dokumentesh” dhe “deklaratë e rreme para oficerit të policisë gjyqësore” – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2014; (2) vendimi datë 27.11.2014, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, të regjistruar në datën 4.11.2014, për veprën penale “deklaratë e rreme para oficerit të policisë gjyqësore” – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2014; (3) vendimi datë 1.12.2014, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, të regjistruar në datën 24.11.2014, për veprat penale “shpërdorim detyre” – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2014; (4) vendimi datë 1.12.2014, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2014, të regjistruar në datën 24.11.2014, për veprat penale “shpërdorim detyre”, “falsifikim dokumentesh”, “mashttrim” dhe “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2014; (5) vendimi datë 23.2.2015, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2015, të regjistruar në datën 9.2.2015, për veprat penale “falsifikim dokumentesh”, “pushtim i tokës” dhe “deklaratë e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore” – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2015; (6) vendimi datë 23.2.2015, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2015, të regjistruar në datën 10.2.2015, lidhur me ankimin ndaj zyrtarëve të komunës K – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2015; (7) vendimi datë 23.2.2015, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti

vendosur mosfillimin e procedimit penal, kryesisht me argumentin se faktet e kallëzuara përbëjnë “gjë të gjykuar”, për shkak se ato janë hetuar më parë në kuadër të një procedimi tjetër penal, me nr. ***, viti 2013.

68.3 Nga verifikimi i kryer nuk u provuan pretendimet e denoncuesit për zvarritje të hetimeve, pasi hetimet janë kryer brenda afateve ligjore, në përputhje me udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.

69. Denoncim nr. * prot, datë 5.7.2019, i shoqërisë përmbarimore “****” shpk**

69.1 Në këtë denoncim, kjo zyrë përmbarimore pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 12.6.2019 ka vendosur pranimin e ankimit të saj dhe kthimin e dosjes përmbarimore që i është sekuestruar kësaj zyre, sipas vendimit gjyqësor të datës 24.12.2018.

69.2 Zyra përmbarimore i është drejtuar prokuroreve Englantina Shehu dhe E.H me kërkesën e datës 21.6.2019, ndërsa në datën 28.6.2019 i drejtoi kërkesë prokurores së rrethit, znj. V.Sh, për kthimin e dosjes përmbarimore, por pa marrë asnjë përgjigje. Në këtë mënyrë, denoncuesi pretendon se subjekti po bëhet pengesë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

69.3 Në lidhje me këtë pretendim të denoncuesit subjektit iu kërkuan shpjegime të shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi veprimet e kryera prej saj në hetimin e kësaj çështjeje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

70. Subjekti i rivlerësimit përmes prapësimeve ka parashtruar rrethanat e kësaj çështje penale, si vijon:

70.1 Shoqëria “****”, dega Shqipëri, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dy kallëzime penale, ku në bazë të shortimit për verifikimin e tyre është ngarkuar prokurorja E.H, e cila, me urdhrin e datës 4.5.2018, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprat penale “ekspertim i rremë” dhe “shpërdorim detyre”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 309 dhe 248 të Kodit Penal.

70.2 Subjekti ka shpjeguar se prokurorja e ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë për sekuestrimin e dy dosjeve përmbarimore, kërkesa të cilat janë pranuar me vendimet gjyqësore nr. *** regj., datë 1.6.2018 dhe nr. ***, datë 24.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Të dyja këto vendime, të ankimuara nga përmbaruesi gjyqësor, janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë.

70.3 Më tej, subjekti ka shpjeguar se në datën 17.1.2019, me vendim të Drejtuesit të Prokurorisë “Për zëvendësimin e prokurorit”, çështja i është ngarkuar subjektit për vijimin e hetimeve, pasi prokurorja E.H kishte marrë leje për arsye familjare nga data 14.1.2019 deri në datën 10.2.2019. Pas kthimit të prokurores E.H, nisur nga fakti se dosja ishte voluminoze dhe kjo e fundit kishte

2015, të regjistruar në datën 17.2.2015, për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” – vendimi i është komunikuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2015.

qenë prokurorja që kishte nisur dhe drejtuar hetimin, subjekti ka kërkuar nga Drejtuesi i Prokurorisë që kjo prokurore të ishte pjesë e grupit hetimor për hetimin e këtij procedimi penal. Sipas shpjegimeve të subjektit, shoqëria përmbarimore ka kërkuar në gjykatë ndryshimin e dy vendimeve të sipërcituara dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 18.4.2019 dhe vendimin nr. ***, datë 12.6.2019, ka vendosur pranimin e kërkesave dhe kthimin e dosjeve përmbarimore. Ndaj këtyre vendimeve gjyqësore është ushtruar ankim nga prokurorët dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimet nr. ***, datë 29.5.2019 dhe nr. ***, datë 12.6.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke urdhëruar mbajtjen nën sekuestro të dosjeve përmbarimore.

70.4 Në përfundim të hetimit, nga ana e prokurorëve, në datën 3.12.2019, është disponuar me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. ***/2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila ka shqyrtuar paralelisht jo vetëm kërkesën e pushimit të paraqitur nga prokurorët, por edhe kërkesën e shoqërisë përmbarimore për kthimin e dy dosjeve përmbarimore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. **, datë 20.2.2020, ka vendosur kthimin e dosjeve përmbarimore.

70.5 Subjekti ka shpjeguar se ky vendim është ekzekutuar nga prokurorja E.H, e cila ka nxjerrë urdhrin e datës 20.2.2020, duke ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore për ekzekutimin e tij. Ky i fundit ka mbajtur procesverbalet për kthimin e dosjeve përmbarimore, duke bërë inventarizim të tyre, të cilat janë nënshkruar dhe marrë në dorëzim nga përmbaruesi gjyqësor.

70.6 Subjekti ka shpjeguar se që nga momenti që janë sekuestruar dosjet përmbarimore shoqëria përmbarimore “****” sh.p.k. ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kërkesa të vazhdueshme për kthimin e dosjeve përmbarimore, kërkesa të cilat ia ka drejtuar për dijeni edhe institucioneve të tjera, si Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

70.7 Në përmbushje të detyrimeve ligjore, nga ana e prokurorit janë marrë në shqyrtim të gjitha këto kërkesa dhe për secilën prej tyre shoqëria përmbarimore ka marrë përgjigje.

70.8 Subjekti e çmon të pabazuar denoncimin e bërë nga përmbaruesi gjyqësor, pasi sekuestrimi i dosjeve gjyqësore është bërë në çdo rast mbi bazën e vendimeve gjyqësore të shkallës së parë dhe të apelit; kërkesat dhe ankesat e palëve janë shqyrtuar po në rrugë procedurale e gjyqësore dhe kthimi përfundimisht i dosjeve është disponuar gjithashtu me vendim gjyqësor, ku prokurori ka bërë ekzekutimin e vendimit gjyqësor, duke ia kthyer dosjet përmbarimore përmbaruesit gjyqësor. Subjekti ka depozituar aktet procedurale që mbështesin shpjegimet e sipërcituara.

Vlerësimi i Komisionit

71. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, përmes shpjegimeve të saj dhe akteve të depozituara në prapësime, arriti të provojë bindshëm arsyet dhe shkaqet ligjore të moszekutimit të vendimit gjyqësor për kthimin e dosjeve përmbarimore të sekuestruara.

71.1 Nga verifikimi i akteve, Komisioni konstaton se subjekti ka vepruar në zbatim të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit, e cila, ndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimet

nr. ***, datë 29.5.2019 dhe nr. ***, datë 9.7.2019, ka rrëzuar kërkesën e shoqërisë përmbartimore, duke lënë nën sekuestro dosjet përmbartimore, ashtu sikurse janë sekuestruar me vendimet e mëparshme të shkallës së parë.

71.2 Përfundimisht, trupi gjykues vlerëson se veprimet e kryera nga subjekti janë konform ligjit, e konkretisht me nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim pasi të ketë marrë formë të prerë.

Konkluzion mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

72. Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurores Englantina Shehu dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Englantina Shehu ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e saj, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të gremës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Englantina Shehu, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 29.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha